



Zyra e Kryetarit

Nr. 11-33/91 2021

Date: 20/09/2021.

Në mbështetje të Ligjit nr.06/L-114, nenit 34, pika 12, për Zyrtarë Publikë të Republikës së Kosovës, dhe të Rregullores Nr.16/2020, për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, neni 7 par.2, neni 18 paragrafi 1 dhe 2.3, Udhëheqësi më i lartë administrativë bënë:

SHPALLJE PUBLIKE

Për angazhimin e: një (1) eksperti të jashtëm, për të qenë pjesë e komisionit në fushën e përzgjedhjes/vlerësimit kandidatëve për konkurset në pranim të fushës/grupit të Gjeodezisë/Kadastër.

Kandidatët që shprehin interesim për angazhim duhet t'i plotësojnë këto kritere:

- Diplomë universitare në fushën : Gjeodezisë/Kadastër
- Së paku 3 vite përvojë pune pas diplomimit, në fushën profesionale.
- Të mos jenë të emëruar politikisht
- Të mos jenë shërbyes civil
- Të mos jenë punëtorë në administratës shtetërore

Të drejtë konkurrimi kanë kandidatë nga organizatat të specializuara që merren me rekrutim apo profesorët e universiteteve të fushës së Gjeodezisë/Kadastrit.

Kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Kopjen e letërnjoftimit
- Një CV
- Dëshmi për shkollimin
- Dëshmi për përvojën e punës
- Dëshmi që nuk është nën hetime
- Referencat apo informatat tjera shtesë, të cilat konsiderohen të rëndësishme për kandidatët që aplikojnë.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit Vlerësues janë të përcaktuara me rregulloren përkatëse si në vijim:

- Vlerësimi i jetëshkrimit që konsiston në vlerësimin e cilësisë dhe nivelit të arsimimit të kandidatëve dhe përvojës domethënëse në punë.
- Vlerësimin e trajnimeve që lidhen me vendin e punës në lëmline përkatëse.
- Vlerësimin e njohurive, aftësive apo cilësive të kandidatit.

Angazhimi në cilësinë e ekspertit të jashtëm nuk nënkupton themelimin e marrëdhënies së përhershme të punës në Komunën e Klinës, mirëpo eksperti do të angazhohet për një periudhë të caktuar kohore 2 vjeçare.

Aplikimi mund të bëhet përmes kopjeve fizike, në Zyrën për Pritjen e Palëve në objektin e Komunës, tetë (8) ditë kalendarike nga dita e shpalljes, respektivisht nga data **21.09.2021, deri më datën 28.09.2021.**

Komisioni vlerësues, pasi të bëjë vlerësimin e aplikacioneve, vetëm kandidatët që i plotësojnë kriteret e kërkuara do të përzgjidhen në listën e ngushtë.

Dokumentet e pa kompletuara dhe të arritura pas afatit nuk do të merren për shqyrtim.

Kryetari i Komunës
Zenun Elezaj